



Tiranë, në 05.05.2015

## **NJOFTIM PËR SHTYP**

### **Mbi mbledhjen e Grupit Këshillimor të Stabilitetit Financiar,**

---

Në datën 4 maj 2015, u zhvillua mbledhja e radhës e Grupit Këshillimor të Stabilitetit Financiar (GKSF). Në këtë mbledhje morën pjesë Ministri i Financave, Guvernatori i Bankës së Shqipërisë, Kryetari i Bordit të Autoritetit të Mbikëqyrjes Financiare, drejtues të Agjencisë së Sigurimit të Depozitave dhe përfaqësues të tjerë të këtyre institucioneve. Mbledhja iu kushtua analizës së treguesve më të fundit të sektorit bankar dhe zhvillimeve që i ndikojnë ato. Diskutimet e të pranishmëve u mbështetën nga prezantimet e përgatitura nga Banka e Shqipërisë dhe Agjencia e Sigurimit të Depozitave.

GKSF-ja vlerësoi se gjendja financiare e sektorit bankar paraqitet e mirë. Gjatë vitit 2014, sektori bankar shënoi një fitim prej 11.2 miliardë lekësh, i shpërndarë më mirë midis bankave në krahasim me një vit më parë. Treguesit e kapitalizimit dhe të likuiditetit janë dukshëm mbi nivelet minimale të kërkuara nga kuadri rregullativ mbikëqyrës. Kështu, raporti i mjaftueshmërisë së kapitalit shënoi vlerën 16.8%, ndërsa aktivet likuide u ngjiten në 40.4% të detyrimeve afatshkurtra. Ritmi i kreditimit ka qenë më i mirë se një vit më parë, ndonëse është ndikuar edhe nga faktorë statistikorë dhe vlerësohet ende i ulët. Raporti i kredive me probleme zbriti në nivelin 22.8%. Pritshmëritë për ecurinë e gjendjes financiare të sektorit bankar gjatë vitit 2015, mbeten pozitive.

Për të vlerësuar ndikimet e mundshme mbi sektorin tonë bankar, në analizën e tij, GKSF-ja u ndal edhe tek vlerësimi i zhvillimeve më të fundit në Eurozonë dhe tek negociatat që po zhvillohen për financimin e borxhit të Greqisë. Duke u përqendruar tek bankat me kapital nga vendi fqinj që operojnë në Shqipëri, GKSF-ja konfirmoi se fakti që këto banka i nënshtrohen tërësisht kuadrit rregullativ mbikëqyrës në vendin tonë ka ndikuar në ndjekjen e një politike aktive nga Banka e

Shqipërisë dhe nga vetë këto banka për të realizuar një ristrukturim gradual të veprimtarisë dhe për të arritur aktualisht nivele mjaft të mira të kapitalit dhe të aktiveve likuide. Si rezultat i veprimeve të përbashkëta të ndërmarra në vazhdimësi, këto banka së bashku e mbyllën vitin 2014 me fitim dhe ekspozimi i tyre ndaj subjekteve e instrumenteve financiare greke, ka zbritur aktualisht në nivele mjaft të ulëta. Mbështetur edhe në rezultatet e ushtrimeve të provës së rezistencës, GKSF-ja vlerëson se këto masa i mbrojnë efektisht këto banka, në rastin e zhvillimeve të pafavorshme në Greqi.

Në përfundim, GKSF-ja vlerësoi se gjendja aktuale financiare e sektorit bankar në tërësi, kuadri ligjor e operacional për administrimin e rreziqeve dhe bashkëpunimi efektiv me industrinë bankare dhe palët e tjera të interesuara, kanë forcuar rezistencën e sektorit bankar ndaj rreziqeve të ndryshme në veprimtarinë e tij. Në përputhje me objektivin e tij, GKSF-ja do të vazhdojë të monitorojë dhe të analizojë rregullisht zhvillimet në sektorin bankar dhe në të gjithë sistemin financiar.